



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 26.08.2019 (e hënë) duke filluar ne ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raporti i korrje-shirjeve për vitin 2019;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:20.08.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.07.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, dhe perfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financar të tremujorit të dytë 2019;
3. Raporti i Auditorit të jashtëm për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i propozimit për pruarjen e vendimit për dhënjën në shfrytëzim të vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi tha: po ju njoftoj se e kemi edhe një kërkesë nga Kryetari i Komunës për formimin e komisionit për dhënje të tokës Komunale në shfrytëzim, në mbledhjen e kaluar e kemi anuluar këtë vendim për asrye se ka ndryshuar ligji për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim pasi që komisioni ka qenë prej 7 antarëve ndërsa tash duhet ti ketë 5 antarë, 2 nga egzekutivi, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile, ne i kemi dy propozime nga egzekutivi që janë Rahim Ahmeti dhe Sladjana Natic dhe dy propozime do ti kemi në mbledhje të Kuvendit.

Kryesusi tha: nese nuk keni ndonjë diskutim a pajtoheni që kjo pikë të hy në rend dite?.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të hy në rend dite.

Kryesuesi i pyeti antarët se ka dikush ndonjë propozim tjetër apo pajtoheni me këtë rend dite?.

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i dites me këtë pikës shtes të propozuar: Formimi i komisionit për dhenje në shfrytëzim dhe ndrrim të pronës së patundshme Komunale;

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit Financar të tremujorit të dytë 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin po besoj që e keni marrë me kohë, të hyrat gjithesej për këtë tremujor janë 44,623 €, i keni në tabel të paraqitura me radh të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga regjistrimi i automjeteve e keshtu me radhë. Më pastaj i keni mjetet e shpenzuara për këtë tremujor

per paga dhe meditim janë shpenzuar 475,373 €, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 72,298 €, shpenzime komunale janë shpenzuar në vlerë prej 20,187 €, për subvencione janë shpenzuar 1,860 € dhe për investime kapitale 15,11 €. I keni ta paraqitura për secilen drejtori veç e veç në material për mos të humbur kohë me i lexu të gjitha nese keni ndonjë pyetje udhëroni, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: po e shohim raportin e tremujorit të dytë që na ka derguar Drejtori por nuk është një raport i mirë nuk është një performancë e mirë, të të hyrat vetanake të hyrat nga objektet publike janë zero ndërsa të qiraja nga prona publike janë 150 € dhe kjo nuk është një performancë e mirë e manaxhimit të financave, gjithashtu permbaruesi privat të zyrja e Kryetarit i ka marrë 13,948 €, të zyrja e Kuvendit i ka marrë 1,511€ dhe të arsimit i mesem 2,039 €. Kjo është në menaxhim jo i mirë i financave dhe ekzekutivit, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: sa i përket të hyrat nga qiraja që i përmendet në këtë tremujorësh nuk kemi pasur, pasi që kanë afat deri në muajin nëntor për të kryer pagesat, sa i përket permbaruesit privat janë disa obligime prej viti 2015/16 dhe në atë kohë nuk kemi pasur mundësi që të kryhen këto pagesa për këtë arsye i kemi marrë prej Kuvendit pasi që ato kanë qenë mjetet e lira dhe ato do të kthehen.

Selatin Nuhiu tha: nuk është hera e parë që kemi kësaj lloji vërejtje dhe nuk është hera e parë që permbaruesi merr mjete nga Komuna e Novobërdës, besoj se edhe ju do të përmirsoni performancën dhe ti paguani fakturat me kohë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një pyetje të shërbimet publike të investimet kapitale janë 7,976 € dhe në zhvillim ekonomik janë investime kapitale 7,135€ nese ke informata me na tregu më sakt se ku janë bërë këto investime.

Sercan Todorovic tha: zyrtarët që punojnë me projekte e din se ku kanë shkuar këto investime, disa edhe kanë qenë participime në projekte.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e tretë: Raporti i Auditorit të jashtëm për vitin 2018;

Kryesuesi tha: nuk është askush që të prezantojë, duhet të kishte ardhur Kujtimi pasi që është auditor por për arsye që nuk i di nuk është prezent, a keni ndonjë diskutim apo pajtoheni që të shkojë kjo pikë në Kuvend dhe të diskutojmë.

Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e katërtë: Shqyrtimi i propozimit për prurjen e vendimit për dhënjën në shfrytëzim të vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Kryesusi tha: propozuesi i kësaj pike nuk është këtu.

Xhejlane Behluli tha: e di se para dy mbledhjeve në komitetet ka qenë zyrtari dhe na ka dhënë informata të mjaftueshme dhe e kemi votuar për Kuvend në Kuvend nuk është votuar pasi nuk ishte prezent por është arsyetuar se ka qenë jashtë vendit, sa i përket për sot edhe unë jam kunder pasi që nuk është prezent por është mirë që të votohet të paktën për Kuvend pasi që kjo besoj se nuk ka të bëjë me Kryetarin, kjo ka të bëjë me shoqatën e gjuetarëve përderisa ata paguajnë antarësi, e nuk ka të bëjë as me zyrtarë Komunal, mendoj se është mirë me u votu për Kuvend pasi që është në interes të gjuetarëve, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: mosprezenca e zyrtarit të bujqësisë tregon që kjo pikë të terhiqet, unë jam që kjo pikë të terhiqet përderisa nuk vin zyrtarët të raportojnë dhe nëse si e dim rreth kësaj pike është duke u marrë edhe gjykata me këtë që është.

Pasi nuk pat diskutime tjera me 1 votë për 4 kunder (Nebojsa Arsic, Milica Jovanovic, Mirjana Simijonovic, Selatin Nuhiu) nuk aprovohet nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e pestë: Formimi i komisionit për dhënjë në shfrytëzim dhe ndërrim të pronës së patundshme Komunale;


Kryesusi tha: është pikë plotësuese për formimin e komisionit për dhënjë në shfrytëzim të pronës Komunale, komisioni do të përbehet prej 5 antarëve, 2 nga ekzekutivi, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile, i kemi dy propozime nga ekzekutivi që janë Rahim Ahmeti dhe Sladjana Natic ndërsa në Kuvend do të kemi edhe dy propozime, nese keni ndonjë diskutim, urdhëroni.

Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.
Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E BUJQËSIS PYLLTARIS DHE ZHVILLIMIT RURAL

DATE/A:	08.08.2019
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal
C.c	z: Slobodan Savic -Drejtore i Bujqësis Pylltaris zhvillimit Rural
NGA/OD/FROM:	z: Avdi vllasaliu -zyrtar i DBPZHR
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i korrje-shirjes-2019

Korrje-shirja në komunën e Novobërdës ka filluar me

Datën : 04.07.2019

Me Grurë, Elbë, Thekër, Tërshër,

dhe ka përfunduar me

Datën : 07.08.2019

Viziten të cilën e kemi bërë në teren me anëtarët e komisionit nga DBPZHR për monitorimin e fushatës së korrje-shirjes.

Gjatë vizitës në teren procesi i korrje-shirjes është kryar në mënyr të rregullt, si nga ana e fermerëve dhe Autokombanjerëve, respektohet qmimi i rekomanduar nga MBPZHR dhe DBPZHR. Korrje-shirja është kryer nga 80-100 euro për 1 ha

Në fushatën e korrje shirjes kanë marrë pjesë: 18 Autokombajnjer

10 Autokombajna nga komuna e Novobërdës

8 Autokombajna nga komunat fqinje. Gjilan, Ranilluki, Kamenica

Rendimentet e deklaruar nga fermeret gjatë vizites në teren në procesi e korrje-shirjes.

Elbë vjeshtor: **3600 Kg.** për: 1 ha

Grur: **4500** kg për: 1 ha

Theker: **3200** kg për: 1 ha

Tërshër: **2500** kg për: 1 ha

Sipërfaqe te korrura me Grur: **720.63** ha

Sipërfaqe te korrura me Elb : **104.64** ha

Sipërfaqe te korrura me Theker: **26.43** ha

Sipërfaqe te Korrura me Tërshër: **51.90** ha

Sipërfaqe te korrura me drithra te bardha janë gjithësej: **903.60** ha

I gjithë procesi i korrje-shirjes është kryar në rregull , pa ekcese

Sa i perkat kushteve atmosferike kanë penguar për tu kryar korrje-shirjen sipas planit operativ te parapar nga DBPZHR